

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1285/Prot.
11

Tiranë, më 30 / 10 / 2020

V E N D I M

Nr.13, datë 30.10.2020

“PËR

DISA NDRYSHIME NË STRUKTURËN E UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS”

Mbështetur në Ligjin Nr.80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 38, pika 1, germa ç, dhe në propozimet e disa njësisve kryesore për disa ndryshime në strukturën aktuale, Senati në mbledhjen e datës 30.10.2020,

V E N D O S I:

Miratimin e disa ndryshimeve në strukturën e Universitetit Politeknik të Tiranës si më poshtë vijon:

1. Në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave


Emërtimi i Departamentit të Gjeologjisë së Zbatuar, Mjedisit dhe Gjeoinformatikës bëhet Departamenti i Gjeologjisë së Zbatuar dhe Gjeoinformatikës.

2. Në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike

Një pozicion pune personel akademik në Departamentin e Automatikës kalon si pozicion pune Specialist IT, pa ndryshuar numrin total të miratuar për këtë njësi kryesore.

3. Në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike

- a. Një pozicion pune personel ndihmësakademik (Laborant) në Departamentin e Prodhim Menaxhimit kalon si pozicion pune Specialist IT,
- b. Një pozicion pune personel ndihmësakademik (Laborant) në Departamentin e Tekstilimit dhe Modës kalon si pozicion pune Specialist SBC, ALUMNI dhe i Karrierës, pa ndryshuar numrin total të miratuar për këtë njësi kryesore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

4. Në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike

Një pozicion pune personel ndihmësakademik në Departamentin e Inxhinierisë Matematike kalon si pozicion pune Specialist SBC, ALUMNI dhe i Karrierës, pa ndryshuar numrin total të miratuar për këtë njësi kryesore.

5. Në IGJEUM

- a. Dy pozicione pune punonjës kërkimorë pranë Departamentit të Ekonomisë Ujore dhe Energjive të Rinovueshme kalojnë dy pozicione për Specialist IT.
- b. Dy pozicione pune specialist pranë Departamentit të Klimës dhe Mjedisit kalojnë dy pozicione specialist për monitorimin pranë Departamentit të Sizmologjisë pa ndryshuar numrin total të miratuar për IGJEUM.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Andrea MALIQARI



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë,
Tel/Fax: +355 4 2227914,
web: www.upt.al